



Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Të gjithë pa dallim kombësie, ngjyre dhe besimi kërkojnë një jetë të mirë. Tani njerëzit janë të ndarë në kërkimin e jetës së bukur, gjejmë një shtrirjen në këto pista: pasuri, autoritet, ndershmëri, pushtet, etj. Historia ishte dëshmitare për të gjitha kategoritë.

Islami na mësoi se jetën e bukur mund të përjetojmë vetëm në dy gjera, në besimi dhe vepra të mirë. Por myslimanët, besimtarët, fetarët sa janë të vëmendshëm në besimi e tyre dhe sa janë veprimtarë serioz?!

Të nderuar!

Ajo që të shqetëson është se “mospërfillja dhe pakujdesia” po preferohet dhe është favorit. Ajo po manifestohet në çështjet parimore të fesë Islame, fundamenteve të besimit, normave fetare, me një fjalë në gjerat thelbësore.

Mos vallë kemi mbërri në atë gjendje që të këqijat që po i servohen popullit tonë (duke filluar nga shamia, lënda fetare, së fundi shamisë i thanë JO), duhet vetëm me zemër ti urrejmë?! Mos vallë janë shterur mundësitë e veprimit me dore, pastaj me gjuhë?!

“Mospërfillja” sëmundje tejte serioze dhe e rrezikshme.

Kjo sëmundje tani po shfaqet edhe më dukshëm te shtresat e besimtarëve, pa përjashtuar asnjë kategori. E kam fjalën te besimtarët praktikues të Islamit, si të duash quaj: fetarët, xhemati, besa edhe duke mos përjashtuar edhe disa prijës, imam, hoxhallarë, profesor, etj..

Çka na ka gjet kështu?

Mendoj që kjo kosto vjen nga “mospërfilljes dhe neglizhencës”, sëmundje shumë e rrezikshme. Mospërfillës në gjërat e vogla, ato më pas rriten. Pakujdesia në çështjet e lehta, ato më pas zmadhohen.

Të nderuar!

????? ?????? ????: ?????? ??????

????? ?????????????????????? ?? ?????? ?????????? ?????????????? ?????? ??????????? ??

???????? ?????????? ????????????? ????????????? ????????????? ?? ??????????

?????????? ?????????? ?????????? ?????????? ??????? ?????????? ??????????

??????? ?????????? ?????? ????????????????? ??? ???????? ?????? ??????????

?????????: ?? ??????????! ??? ??????????! ??? ??????????! ??? ?? ?????????

Tregon Hudhejfa Allahu qoftë i kënaqur: I Dërguari i Allahut sal-Allahu alejhi ve selem na tregoi dy rrëfime, njërin prej të cilëve e kam parë të ndodhë dhe po pres për tjetrin.

Ai na foli gjithashtu edhe për humbjen e tij (Amanetit) duke na thënë:

“Do të shkojë njeriu të flejë dhe do t'i hiqet Amaneti nga zemra e tij duke i mbetur vetëm gjurmët e tij si gjurmët e zjarrit. Pastaj do të flejë përsëri nga ku do t'i hiqet edhe ajo gjurmë e tij nga zemra duke i mbetur vetëm një shenjë si ajo e një filluske që ngrihet mbi lëkurë kur në këmbë bie një gacë zjarri; dhe në të vërtetë kjo filluskë nuk ka brenda asgjë. Kështu pra, do të vijë një ditë kur njerëzit do të bëjnë tregti me njëri tjetrin, por vështirë se do të gjesh ndonjë të besuar mes tyre. Pastaj do të thuhet se në filan fisin është një njeri i besuar, njeri që do të çmohet për zgjuarsinë e tij, për sjellje të mira dhe për forcën e besimit dhe të karakterit që ka, edhe pse në të vërtetë ai nuk do të ketë Iman (besim) në zemër as sa një farë mustarde!” (Shënon Buhariu)

“Do të shkojë njeriu të flejë” do të thotë: do të jetë i pakujdesshëm në përgjegjësinë që ka, detyrimet që i ka para Allahut, i neglizhon ato, tregon pakujdesi. Kur ai ushtron këtë standard Muhamedi sal-Allahu lajhi ve selem na tregon se “do t’i hiqet Amaneti (besimi) nga zemra e tij duke i mbetur vetëm gjurmët”. Por ai përsëri vazhdon në gjum: “Pastaj do të flejë përsëri” tani gjumi i dytë ia largon përfundimisht “do t’i hiqet edhe ajo gjurmë e tij nga zemra duke i mbetur vetëm një shenjë”.

Dy herë në gjumë, këtu shfaqet pakujdesia, neglizhenca, mospërfillja! Ndodh një problem, bëhet një gjynah, merret një vendim në dëm të Islamit, ne “rrotullohemi” në krahun tjetër dhe vazhdojmë gjumin. Pastaj po vjen ndodhia e dyte, e tretë, ende në gjumë! Allahu na ruajt, mos vallë lëre që nuk po mbetet imani e as gjurma, por vetëm një shenjë flluske e mbushur me ajër!!

Të nderuar fetarë!

Mëso se mospërfillja, neglizhenca e njëpasnjëshme kanë sjell zemrën në atë gjendje “ai nuk do të ketë Iman (besim) në zemër as sa një farë mustarde!”

Kur zemra të jetë në këtë gjendje, kush të beson më!?

Ja pra mospërfillja ku na çon!

Ulvi Fejzullahu